

MEKANIZMI I RAPORTIMIT TË PAVARUR (MRP):

SHQIPËRIA RAPORTI PËRFUNDIMTAR 2014–2016

Gjergji Vurmo
Hulumtues i pavarur
Raporti i dytë përfundimtar
Second End-of-Term Report

Open
Government
Partnership

INDEPENDENT
REPORTING MECHANISM

INDEPENDENT REPORTING MECHANISM (IRM): ALBANIA END-OF-TERM REPORT 2014-2016

Albania has made progress implementing commitments in the fight against corruption. The government launched the portal for reporting corruption, and the Parliament passed the Whistleblower Protection Law. At the end of the action plan, a number of commitments remained limited in completion, and some improvements led to a marginal increase in access to information. To improve Albania's performance in OGP, government and civil society can take advantage of the multi-stakeholder forum, established in March 2016, to monitor progress of commitments.

The Open Government Partnership (OGP) is a voluntary international initiative that aims to secure commitments from governments to their citizenry to promote transparency, empower citizens, fight corruption, and harness new technologies to strengthen governance. The Independent Reporting Mechanism (IRM) carries out a review of the activities of each OGP participating country. This report summarizes the results from July 2014 to June 2016 and includes relevant developments up to September 2016.

The Ministry of State for Innovation and Public Administration (MSIPA) is the lead institution coordinating OGP in Albania. The Inter-Ministerial Working Group (IWG), lead by MSIPA, is responsible for the development and implementation of the action plan, and only representatives from government agencies are members. An informal multi-stakeholder forum—"OpenAlb," which is composed of representatives from civil society and central government institutions (IWG members)—has been in place since March 2016. OpenAlb aims to provide a regular forum for government, civil society organizations (CSOs), and other stakeholders to review the OGP process and take action. This multi-stakeholder forum has been particularly active in the design and consultations for the third OGP action plan.

In July 2016, Albania submitted its third OGP action plan 2016–2018 and in October 2016 published the end-of-term self-assessment report on implementation of the OGP 2014–2016 action plan.

Two commitments on e-Albania and the Whistleblower Protection Law were carried forward to the 2016–2018 action plan. Two other commitments on the electronic registry of permits and the promotion of OGP values with local governments were partially carried forward. Elements of these commitments are reflected in the new commitment on open standards for contracting and the publication of local government legislation in open systems.

TABLE 1: AT A GLANCE

NUMBER OF COMMITMENTS: 13
NUMBER OF MILESTONES: 0

LEVEL OF COMPLETION

	MID-TERM	END-OF-TERM
COMPLETED:	0	2
SUBSTANTIAL:	5	4
LIMITED:	7	7
NOT STARTED:	1	0

NUMBER OF COMMITMENTS WITH:

CLEAR RELEVANCE TO OGP VALUES:	9	9
TRANSFORMATIVE POTENTIAL IMPACT	1	1
SUBSTANTIAL OR COMPLETE IMPLEMENTATION	5	6
ALL THREE (★):	0	1

DID IT OPEN GOVERNMENT

MAJOR	N/A	0
OUTSTANDING	N/A	0

MOVING FORWARD

COMMITMENTS CARRIED OVER TO NEXT ACTION PLAN:	2
---	---

Table 2. Overview: Assessment of Progress by Commitment

COMMITMENT OVERVIEW	SPECIFICITY				OGP VALUE RELEVANCE <i>(as written)</i>				POTENTIAL IMPACT				COMPLETION		MID-TERM		DID IT OPEN GOVERNMENT?				
	None	Low	Medium	High	Access to Information	Civic participation	Public Accountability	Technology & Innovation for Transparency & Accountability	None	Minor	Moderate	Transformative	Not started	Limited	END-OF-TERM		Worsens	Did not change	Marginal	Major	Outstanding
															Substantial	Complete					
1.2. Electronic registry of energy and industry permits		X			X			X					X					X			
1.4. Promoting OGP values with local authorities	X				Unclear				X				X							X	
2.1. Database on economic assistance beneficiaries			X		Unclear						X				X			X			
3.2. National geoportal				X	X					X			X						X		
4.2. Police service offices				X	X		X	X		X					X				X		
Cluster 1: Denouncing corruption																					
1.1 Standardization of corruption complaints			X							X					X				X		
4.1. Whistleblower Protection Law				X			X				X		X						X		

COMMITMENT OVERVIEW	SPECIFICITY				OGP VALUE RELEVANCE <i>(as written)</i>				POTENTIAL IMPACT				COMPLETION		MID-TERM END-OF-TERM		DID IT OPEN GOVERNMENT?				
	None	Low	Medium	High	Access to Information	Civic participation	Public Accountability	Technology & Innovation for Transparency & Accountability	None	Minor	Moderate	Transformative	Not started	Limited	Substantial	Complete	Worsens	Did not change	Marginal	Major	Outstanding
Cluster 2: Open data & e-services																					
1.3. Public expenses in open data			X		X			X			X				X			X			
3.3. E-Albania			X		X			X			X				X				X		
Cluster 3: Open access on natural resources data																					
2.2. Electronic portal on water resources management			X		X						X			X				X			
3.1. Electronic access to protected areas		X			X	X		X			X			X				X			
Cluster 4: Simplified customs services																					
2.3. Single window			X		Unclear					X				X				X			
3.4. E-document			X		Unclear				X					X				X			

MEKANIZMI I RAPORTIMIT TË PAVARUR (MRP): SHQIPËRIA RAPORTI PËRFUNDIMTAR 2014-2016

Shqipëria ka bërë progres në zbatimin e angazhimeve që kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit. Qeveria krijoi portalin për denoncimin e korrupsionit, ndërsa Kuvendi miratoi Ligjin "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve". Në fund të planit të veprimit, përfundimi i zbatimit të disa angazhimeve ka mbetur i kufizuar, ndërkohë që disa përmirësime kanë rezultuar në rritje të lehtë të aksesit në informacion. Për të përmirësuar performancën e Shqipërisë në PQH, qeveria dhe shoqëria civile mund të shfrytëzojnë forumin shumëpalësh të ngritur në muajin mars 2016 për të monitoruar ecurinë e zbatimit të angazhimeve.

Partneriteti për Qeverisje të Hapur (PQH) është një nismë vullnetare ndërkombëtare që synon të sigurojë angazhime të qeverive ndaj qytetarëve për të promovuar transparencën, fuqizimin e qytetarëve, luftën kundër korrupsionit, dhe për të shfrytëzuar teknologjitë e reja për forcimin e qeverisjes. Mekanizmi i Raportimit të Pavarur (MRP) shqyrton aktivitetet e secilës qeveri pjesëmarrëse në PQH. Ky raport bën një përmbledhje të rezultateve nga muaji korrik 2014 deri në qershor 2016 dhe përfshin edhe zhvillimet përkatëse deri në shtator 2016.

Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MSIAP) është institucioni kryesor koordinues i PQH në Shqipëri. Grupi Ndër-ministor i Punës (GNP), i kryesuar nga MSIAP, është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e planit të veprimit (PV) dhe anëtarë të tij janë vetëm përfaqësuesit e institucioneve qeveritare. Organizata të shoqërisë civile (OSHC) nuk janë të përfshira në GNP. Që nga muaji mars 2016 është ngritur një forum informal shumëpalësh, OpenAlb, i cili përbëhet nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucioneve qendrore qeveritare. Forumi OpenAlb synon të ofrojë një mundësi për qeverinë, organizatat e shoqërisë civile (OSHC) dhe aktorët e tjerë me qëllim shqyrtimin e procesit PQH dhe marrjen e masave përkatëse. Ky forum shumëpalësh ka qenë mjaft aktiv në hartimin dhe konsultimet për planin e tretë të veprimit të PQH.

Në korrik 2016, Shqipëria dorëzoi planin e saj të tretë të veprimit PQH 2016-2018 dhe në tetor 2016 publikoi raportin përfundimtar vetë-vlerësues për zbatimin e planit të veprimit PQH 2014-2016.

Dy angazhimet për e-Albania dhe Ligjin "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" u mbartën për planin e veprimit 2016-2018. Dy angazhimet e tjera për regjistrin elektronik të lejeve dhe promovimin e vlerave PQH

TABELA 1: NË NJË SHIKIM

NUMRI I ANGAZHIMEVE: 13
NUMRI I ARRITJE E SYNUAR: 0

NIVELI I PËRFUNDIMIT

	AFATMESËM	PËRFUNDIMTAR
PËRFUNDUAR:	0	2
I KONSIDERUESHËM:	5	4
I KUFIZUAR:	7	7
NUK KA FILLUAR:	1	0

NUMRI I ANGAZHIMEVE:

QARTËSISHT RELEVANTE ME VLERAT E PQH:	9	9
ME NDIKIM POTENCIAL TRANSFORMUES	1	1
TË ZBATUARA KONSIDERUESHËM OSE PLOTËSISHT	5	6
TË TREJA (G):	0	1

A SIGUROI QEVERISJE TË HAPUR

KONSIDERUESHËM	N/A	0
JASHTËZAKONISH	N/A	0

DREJTIMI PËRPARA

NUMRI I ANGAZHIMEVE TË MBARTURA PËR NË PLANIN TJETËR TË VEPRIMIT:		2
---	--	---

tek njësitë e qeverisjes vendore (NJQV) u mbartën pjesërisht për planin tjetër të veprimit. Elementë të këtyre angazhimeve reflektohen në angazhimin e ri për standardet e hapura për kontraktimin dhe publikimin e vendimeve të NJQV-ve (ose legjislacionin për qeverisjen vendore) në sisteme të hapura.

KONSULTIMI ME SHOQËRINË CIVILE GJATË ZBATIMIT

Vendet që marrin pjesë në PQH ndjekin një proces konsultimi gjatë hartimit të planeve të veprimit PQH dhe gjatë zbatimit të tyre.

Krahasuar me ciklin e planit të veprimit 2012-2013, procesi i hartimit të ciklit 2014-2016 është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme. Koalicioni i OSHC për PQH në Shqipëri, i krijuar në dhjetor 2013, mori një rol kryesor në organizimin e konsultimeve me pjesëmarrje për hartimin e planit të veprimit 2014-2016. Megjithatë, koalicioni ishte më pak aktiv gjatë zbatimit të planit të veprimit. Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MSIAP) mbajti një kanal të hapur komunikimi dhe shkëmbimi me OSHC-të e interesuara. Takimet mes institucioneve të qeverisë mbetën të mbyllura, organizatat e shoqërisë civile nuk ishin të ftuara në mbledhjet e GNP-së, dhe nuk ka pasur takime të rregullta me OSHC-të deri në fillim të vitit 2016. Ndërveprimet mes qeverisë dhe shoqërisë civile (kryesisht anëtarët e Koalicionit të OSHC-ve për PQH Shqipëri) rinisën nga fillimi i vitit 2016 dhe u fokusuan kryesisht në krijimin e forumit shumëpalësh, OpenAlb, si dhe në konsultimet për planin e tretë të veprimit (2016-2018).¹ Një takim i përbashkët organizuar nga MSIAP dhe forumit OpenAlb ishte planifikuar për t'u mbajtur në tetor të vitit 2016. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte të prezantonte planin e tretë të veprimit PQH, të diskutonte në lidhje me hapat e ardhshëm për zbatimin e tij, dhe të nxirrte mësimet nga përvoja e zbatimit të planit të mëparshëm të veprimit.

Tabela 2: Procesi i konsultimit të planit të veprimit

FAZA E PLANIT TË VEPRIMIT	KËRKESA E PROCESIT PQH (NENET E SEKSIONIT TË QEVERISJES)	A I PËRMBUSHI QEVERIA KËTO KËRKESA ?
Gjatë zbatimit	Forum i rregullt për konsultim gjatë zbatimit?	Jo
	Konsultimet: të hapura apo vetëm ftesa?	N/A
	Konsultime për spektrin IAP2 ²	N/A

¹ Forumi shumëpalësh OpenAlb përbëhet nga përfaqësues të qeverisë dhe anëtarë të shoqërisë civile që punojnë për PQH Shqipëri, kryesisht anëtarë të Koalicionit të OSHC-ve për PQH Shqipëri. Ky forum trajton çështje të zhvillimit të shoqërisë civile, qeverisjen e mirë, mjedisin, të dhënat e hapura, gazetarinë investigative, etj. Burimi: Dokument shqyrtimi i Forumit Shumëpalësh OpenAlb dhe intervistë me Artela Mitrushin, OpenAlb-IDM.

² "Spektri IAP2 për Pjesëmarrjen Politike," Shoqata Ndërkombëtare për Pjesëmarrjen Publike (International Association for Public Participation) http://c.ymcdn.com/sites/www.iap2.org/resource/resmgr/Foundations_Course/IAP2_P2_Spectrum.pdf

ECURIA NË ZBATIMIN E ANGAZHIMIT

Të gjithë treguesit dhe metoda e përdorur në kërkimin Metodës së Raportimit të Pavarur (MRP) mund të gjendet në Manualin e Procedurave MRP që aksesohet në adresën: <http://www.opengovpartnership.org/about/about-irm>. Një masë ka nevojë për shpjegim të mëtejshëm për shkak të interesit të veçantë që paraqet për lexuesit dhe dobisë në inkurajimin e garës drejt kreut mes vendeve pjesëmarrëse në PQH: “angazhimet me yje” (★). Angazhimet me yje konsiderohen angazhimet ekzemplare PQH. Për të marrë një yll, secili angazhim duhet të përmbushë disa kritere:

1. *Duhet të jetë aq specifik (i detajuar) sa të mundësojë gjykimin për ndikimin e tij të mundshëm. Angazhimet me yje duhet të kenë nivel detajimi “mesatar” ose “të lartë”.*
2. *Gjuha e angazhimit duhet të bëjë të qartë lidhjen e këtij të fundit me qeverisjen e hapur. Në mënyrë të veçantë, duhet të përcaktohet lidhja (relevanca) me të paktën një nga vlerat PQH të aksesit tek informacioni, pjesëmarrja qytetarë apo llogaridhënia publike.*
3. *Angazhimi ka ndikim të mundshëm “transformues” nëse zbatohet plotësisht.*
4. *Së fundi, angazhimi duhet të evidentojë progres të dukshëm gjatë periudhës së zbatimit të planit të veprimit, duke marrë renditjen zbatimi “i konsiderueshëm” ose “i përfunduar”.*

Në bazë të këtyre kritereve në periudhën afatmesme, plani i veprimit i Shqipërisë nuk kishte asnjë angazhim me yll. Në fund të periudhës, sipas ndryshimeve në nivelin e përfundimit, plani i veprimit i Shqipërisë kishte një angazhim me yll (Angazhimi 4.1 – për miratimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve).

Angazhimet e vlerësuar si angazhime me yje në raportin afatmesëm mund ta humbasin statusin e tyre me yje nëse përfundimi i tyre në fund të ciklit të zbatimit të planit të veprimit nuk ka është i konsiderueshëm ose i plotë, që do të thotë se përfundimi i tyre i përgjithshëm është i kufizuar në fund të periudhës, sipas gjuhës së angazhimit.

Së fundi, grafikët në këtë seksion paraqesin një pjesë nga pasuria e të dhënave që MRP mbledh gjatë ecuresë së procesit të raportimit. Për të gjithë setin e plotë të bazës së të dhënave për Shqipërinë, shih Eksplorier PQH në adresën www.opengovpartnership.org/explorer.

NË LIDHJE ME “A MUNDËSOI QEVERISJE TË HAPUR?”

Shpesh, angazhimet PQH formulohen me gjuhë të paqartë apo nuk kanë lidhje të qartë me qeverisjen e hapur, por faktikisht arrijnë reforma të rëndësishme politike. Në raste të tjera, angazhimet me progres të rëndësishëm mund të duken relevante dhe ambicioze, por dështojnë në hapjen e qeverisë. Në përpjekje për të kapur këto hollësi dhe, ajo që është më e rëndësishme, ndryshimet aktuale në praktikën e qeverisë, MRP prezantoi një variabël të ri – “a mundësoi qeverisje të hapur” - në raportet përfundimtare. Ky variabël synon të shkojë përtej matjes së produkteve dhe rezultateve duke u përqendruar në ndryshimet që i janë bërë praktikave të qeverisë si rezultat i zbatimit të angazhimit. Kjo gjë mund të krahasohet si për kontrast me “angazhimet me yje” të MRP, të cilat përshkruajnë ndikimin e mundshëm.

Hulumtuesit MRP e vlerësojnë pyetjen “a mundësoi qeverisje të hapur?” në lidhje me secilën vlerë PQH që ka të bëjë me angazhimin. Shtrohet pyetja: “A i shtriu praktikën qeveritare përtej punës së zakonshme?” Shkalla e vlerësimit është si më poshtë:

- I përkeqësoi: përkeqësoi qeverisjen e hapur si rezultat i masave të ndërmarra nga angazhimi
- Nuk i ndryshoi: nuk ndryshoi status quo-në e praktikave të qeverisë
- Paksu: janë bërë disa ndryshime, por të vogla për sa i përket ndikimit tek niveli i hapjes së qeverisë.

- Konsiderueshëm: një hap drejt qeverisjes së hapur në fushën përkatëse të politikës, por mbetet i kufizuar në fushëveprim apo shkallë.
- Jashtëzakonisht shumë: një reformë që ka transformuar “punën e zakonshme” në fushën përkatëse të politikës duke nxitur qeverisjen e hapur.

Për të vlerësuar këtë variabël, hulumtuesit përcaktojnë status quo-në që në fillim të planit të veprimit. Më pas, ata vlerësojnë rezultatet siç janë zbatuar për ndryshimet në hapjen e qeverisë.

Lexuesit duhet të kenë parasysh kufizimet. Raportet përfundimtare të MRP përgatiten vetëm pak muaj pasi ka përfunduar cikli i zbatimit. Variabli fokusohet tek rezultatet që mund të vëzhgohen në praktikat e hapjes së qeverisë në fund të periudhës dyvjeçare të zbatimit. Raporti dhe variabli nuk kanë si qëllim të vlerësojnë ndikimin, për shkak të implikimeve të ndërlikuara metodologjike dhe kuadrit kohor të raportit.

Tabela 4: Përmbledhje: Vlerësimi i progresit sipas angazhimit

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN PQH (siç është shkruar)				NDIKIMI I MUNDSHËM				PËRFUNDIMI		AFATMESËM PËRFUNDIMTAR		A MUNDËSOI QEVERISJE TË HAPUR?				
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përqendrosur	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
1.2. Regjistri elektronik i lejeve në sektorin e industrisë dhe energjetikës		X			X		X			X				X			X				
1.4. Promovimi i vlerave PQH tek autoritetet vendore	X				E paqartë				X				X						X		
2.1. Baza e të dhënave për përfituesit e ndihmës ekonomike			X		E paqartë						X			X			X				
3.2. Gjeoportali Kombëtar				X	X		X			X			X						X		
4.2. Zyrat e Shërbimit Policor				X	X	X	X			X				X					X		
Grupi 1: denoncimi i korrupsionit																					
1.1. Standardizimi i ankesave kundër korrupsionit			X			X				X				X					X		
4.1. Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve				X		X				X			X						X		

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN PQH (siç është shkruar)				NDIKIMI I MUNDSHËM				PËRFUNDIMI		AFATMESËM		A MUNDËSOI QEVERISJE TË HAPUR?				
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
Grupi 2: Të dhënat e hapura dhe e-shërbimet																					
1.3. Shpenzimet publike në formatin e të dhënave të hapura			X		X			X			X			X	X						X
3.3. E-Albania			X		X			X			X				X					X	
Grupi 3: Akses i hapur për të dhënat e burimeve natyrore																					
2.2. Portali elektronik për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore			X		X						X		X	X							X
3.1. Akses i elektronik tek Zonat e Mbrojtura		X			X	X		X			X		X	X							X
Grupi 4: Shërbime të thjeshtësuara doganore																					
2.3. Sporteli unik			X		E paqartë					X			X	X							X
3.4. Dokumenti elektronik			X		E paqartë				X				X	X							X

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMEVE

Si pjesë e PQH-së, vendeve u kërkohet të ndërmarrin angazhime në planin dy-vjeçar të veprimit. Raportet përfundimtare vlerësojnë një matës tjetër, “a mundësoi qeverisjen e hapur?” Tabelat e mësipërme dhe të mëposhtme japin një përmbledhje të nivelit të përfundimit në fund të periudhës dhe ecurinë e këtij matësi. Për më shumë informacione për angazhimet e përfunduara më parë, lutemi shihni Progres Raportin e ndërmjetëm të Mekanizmit të Raportimit të Pavarur MRP për Shqipërinë.¹

Struktura e këtij raporti është paksa e ndryshme nga ajo e planit të veprimit. Raporti bën një vlerësim të pesë angazhimeve veç e veç dhe grupon tetë angazhime të tjera në katër grupe. Fillimisht, plani i Shqipërisë kishte 13 angazhime, por për të kuptuar më mirë procesin, raporti MRP ka bërë një riorganizim të angazhimeve të këtij plani veprimi. Grupimi u bë për angazhimet që kanë si objektiv një prioritet specifik (p.sh., lufta kundër korrupsionit) apo ato që i përkasin një sektori (p.sh., doganat). Grupet janë si më poshtë:

- Denoncimi i korrupsionit
- Të dhënat e hapura & e-shërbimet
- Akses i hapur tek të dhënat e burimeve natyrore
- Shërbime të thjeshtësuara doganore

¹Progres Raporti i Mekanizmit të Raportimit të Pavarur (MRP) 2014–15: Shqipëria, http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_Second%20IRM%20Report_for%20public%20comment.pdf.

1.2 | REGJISTRI ELEKTRONIK I LEJEVE NË SEKTORIN E INDUSTRIJË DHE ENERGJETIKËS

Teksti i angazhimit:

Regjistri elektronik i autorizimeve, lejeve dhe marrëveshjeve të bëra nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë. Kjo ministri, në kuadrin e rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë, ka ndërmarrë nismën e Regjistrimit Elektronik, me synim krijimin dhe botimin në faqen e saj në internet të një regjistri elektronik për autorizimet, lejet, dhe marrëveshjet e dhëna në fushat përkatëse dhe statusi i tyre i përditësuar. Aktualisht ka mungesë informacioni jo vetëm për procedurat për marrjen e një autorizimi apo lejeje, por edhe qytetarët, grupet e interesit, shoqëria civile nuk kanë informacion mbi numrin e lejeve dhe autorizimeve të dhëna në sektorin e energjisë dhe industrisë. Për të trajtuar këtë problem dhe për të siguruar transparencë të plotë mbi gjendjen e aktorëve që veprojnë në këto fusha, Ministria ka nisur procesin e identifikimit të gjendjes aktuale, gjë do të mundësojë një proces më të lehtë monitorimi. Ky sistem regjistri do të ndihmojë në përmirësimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë së kësaj ministrie, por do t'i japë akses tek informacioni nëpërmjet regjistrimit elektronik.

Institucioni përgjegjës: Ministria e Energjetikës dhe Industrisë

Institucion(et) mbështetës(e): N/A

Data e fillimit: 2014

Data e mbarimit: 2016

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN PQH (siç është shkruar)				NDIKIMI I MUNDSHËM				PËRFUNDIMI		AFATMESËM		A MUNDËSOI QEVERISJE TË HAPUR?				
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përqësioi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
		X			X		X			X				X				X			
													X								

SYNIMI I ANGAZHIMIT

Ky angazhim synon të krijojë një regjistër elektronik për dhënien e autorizimeve, lejeve dhe marrëveshjeve në sektorin e energjisë dhe industrisë, duke mundësuar qasjen e publikut tek informacioni për operatorët në këtë sektor. Krijimi i regjistrimit elektronik të koncesioneve në sektorin e energjisë dhe industrisë përfaqëson vazhdimin e angazhimit të Shqipërisë për e-koncesionin sipas Planit të parë të Veprimit PQH 2012-13.

Edhe pse angazhimi në planin e parë të veprimit kishte të bënte me krijimin e një procedure elektronike për koncesionet, angazhimi i planit të dytë të veprimit fokusohet në transparencën dhe aksesin e publikut tek autorizimet, lejet dhe marrëveshjet e bëra nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MIE).

Angazhimi është pjesërisht në përputhje me një rekomandim të shoqërisë civile, rekomandim që u propozua gjatë konsultimeve për planin e veprimit (mars 2014), që trajtonte transparencën për firmat që operojnë në industrinë nxjerrëse në Shqipëri.

STATUSI

Periudha afatmesme: I kufizuar

MEI përfundoi fazën fillestare të projektit të regjistrimit elektronik dhe po punonte për krijimin e sistemit të monitorimit dhe informimit për koncesionet. Ndryshimet në Ligjin për Koncesionet dhe Partneritetet Publike-Private (korrik 2015) bënë të nevojshme nxjerrjen e akteve të tjera nënligjore që rregullonin regjistrin elektronik.¹

Afati përfundimtar: I kufizuar

Sipas raportit të vetëvlerësimit të qeverisë (shtator 2016), nuk ka pasur progres të mëtjshëm. Në shkurt 2016, MEI përditësoi bazën e të dhënave të lejeve aktive në industrinë minerare.² Në 3 mars 2016, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin "Për krijimin dhe administrimin e regjistrimit elektronik të koncesionit/partneritetit publik privat". Megjithatë, faqja zyrtare e Agjencisë së Koncesioneve nuk ka asnjë informacion për Regjistrin e Koncesioneve.³ Raporti i vetëvlerësimit të qeverisë thekson se deri në shtator 2016 MEI nuk kishte përfunduar sistemin e monitorimit dhe informimit për koncesionet.

A MUNDËSOI QEVERISJEN E HAPUR?

Aksesi tek informacioni: Nuk ndryshoi

Regjistri elektronik i koncesioneve mund të kontribuojë në rritjen e transparencës në sektorët e energjisë dhe industrisë. Energjia, sidomos hidrocentralet, dhe shfrytëzimi i burimeve minerale, si bakri, përbën një aktivitet të rëndësishëm dhe në rritje të ekonomisë shqiptare. Ndikimi i mundshëm i regjistrimit varet kryesisht nga lloji i informacionit dhe të dhënave që ofron për publikun. Duke qenë se regjistri nuk është krijuar ende dhe nuk është bërë publik në internet gjatë periudhës së planit të veprimit, ky angazhim nuk ka përmirësuar aksesin tek informacioni.

PËRCJELLË MË TEJ?

Angazhimi është përfshirë në planin e ri të veprimit 2016-2018. Në mënyrë specifike, angazhimi 1.8 për standardet e hapura për lidhjen e kontratave i referohet regjistrimit elektronik. Për të zbatuar me sukses këtë angazhim, plani i veprimit bazohet tek bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe agjencitë e tjera përkatëse. Angazhimi i ri reflekton pjesërisht rekomandimet e raportit të ndërmjetëm MRP 2015, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me bashkëpunimin e OSHC-të me përvojë dhe nevojën për bashkërendim me institucionet e tjera shtetërore. Megjithatë, formulimi i këtij angazhimi është i paqartë, veçanërisht për sa i përket aktiviteteve specifike dhe afateve të përcaktuara.

¹ Progres Raporti MRP, http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_Second%20IRM%20Report_for%20public%20comment.pdf.

² Ministria e Energjisë dhe Industrisë, baza e të dhënave për lejet aktive, http://www.energija.gov.al/files/userfiles/minierat2/2016/RREGJ_LEJEVE_SHKURT_2016_Aktive.pdf.

³ Agjencia e Koncesioneve, http://www.atrako.gov.al/?page_id=112.

1.4 | PROMOVIMI I VLERAVE PQH TEK AUTORITETET VENDORE

Teksti i angazhimit:

Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore dhe koalicionin e shoqërisë civile për PQH do të ndërmarrin së bashku angazhimin për promovimin dhe përfshirjen e autoriteteve vendore tek vlerat PQH. Ky angazhim u propozua nga organizatat e shoqërisë civile me qëllim prezantimin dhe promovimin e vlerave themelore të PQH edhe tek njësitë e qeverisjes vendore. Synimi është të përfordhet mekanizmi i pjesëmarrjes dhe të krijohet qeverisja e hapur edhe në nivel vendor. Disa nga veprimet që do të ndërmerren janë veprimtari promovuese, ndryshimet ligjore për nxitjen e transparencës dhe vlerave të tjera PQH.

Institucioni përgjegjës: Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore

Institucion(et) mbështetës(e): Koalicioni i OSHC-ve për PQH Shqipëri

Data e fillimit: 2014

Data e mbarimit: 2016

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN PQH (siç është shkruar)				NDIKIMI I MUNDSHËM				PËRFUNDIMI		AFATMESËM		A MUNDËSOI QEVERISJE TË HAPUR?				
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përikeqësori	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
	X				E paqartë				X				X						X		
													X								

SYNIMI I ANGAZHIMIT:

Ky angazhim ka për qëllim promovimin e vlerave PQH tek pushteti vendor. Ashtu siç është shkruar, angazhimi përkrahur vetëm aktivitetin "për të promovuar dhe për të angazhuar autoritetet vendore në vlerat PQH," dhe kjo nuk përfshin informacion mbi rezultate të veçanta ose ndikimin e tyre.

STATUSI

Periudha afatmesme: Nuk ka filluar ende

INë harkun njëvjeçar nuk është bërë asnjë përparim. MSIAP, MSHÇV dhe OSHC-të nuk kanë ndërmarrë asnjë hap. Raporti vetë-vlerësues i qeverisë vëren se zbatimi i këtij angazhimi nuk ka nisur ende pavarësisht përpjekjeve të koalicionit të OSHC-ve për të mbledhur fonde.¹

Afati përfundimtar: I kufizuar

Vetëvlerësimi përfundimtar i qeverisë thekson se ky angazhim është zbatuar pjesërisht.² Anëtarët e Koalicionit të OSHC-ve për PQH Shqipëri, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), Lëvizja Mjaft!, dhe InfoÇip kanë zbatuar projekte të veçanta me autoritetet e NJQV-ve për të promovuar vlerat dhe procesin PQH.³ Disa anëtarë të koalicionit OSHC kanë kryer aktivitete ndërgjegjësimi me autoritetet e qeverisjes vendore në disa bashki (Shkodër, Fier, etj.). Në vitin e fundit (2015–2016) nuk është ndërmarrë ende asnjë përpjekje sistematike dhe e koordinuar mes qeverisë qendrore dhe koalicionit OSHC.

A MUNDËSOI QEVERISJEN E HAPUR?

Aksesi tek informacioni: i vogël

Përpjekjet për të promovuar vlerat tek NJQV-të ka çuar në rritje të ndërgjegjësimit mes disa prej njësive të qeverisjes vendore. Edhe pse përpjekjet e koalicionit OSHC nuk kanë pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në hapjen e qeverisë, ato kanë inkurajuar NJQV-të të ndërmarrin programin PQH me angazhime konkrete. Bashkia e Tiranës, që u angazhua në veprimtari të ndryshme PQH për shkak të rritjes së ndërgjegjësimit në nivel kombëtar, ofroi një shembull pozitiv të ndikimit të PQH nëpërmjet krijimit të aplikacionit Tirana Ime (<http://www.tirana.al/aplikacioni-tirana-ime/>). Ky aplikacion ka 6 kategori të ndryshme (trafiku, transporti, ndotja, informacioni, raportime dhe turizmi). Kryetari i Bashkisë së Tiranës e prezantoi këtë aplikacion në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (përfshirë këtu edhe Samitin PQH në Meksikë në tetor 2015). Seksioni “raportime” i këtij aplikacioni u mundëson qytetarëve të bëjnë ankesat apo raportime të tjera për shërbime të ndryshme të bashkisë.

PËRCJELLË MË TEJ?

Ky angazhim u mbart në planin e ri të veprimit. MSHÇV dhe InfoÇip, që është anëtar i Koalicionit të OSHC-ve për PQH Shqipëri, publikuan legjislacionin qendror dhe vendor në sisteme të hapura dhe falas. InfoÇip administron një portal kombëtar (www.vendime.al) ku botohen akte ligjore të miratuara nga njësitë e qeverisjes vendore.

¹ Progres Raporti MRP, http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_Second%20IRM%20Report_for%20public%20comment.pdf.

² Qeveria shqiptare, vetë-vlerësimi përfundimtar (shtator 2016).

³ Intervista me përfaqësues të IDM, Mjaft!, dhe InfoÇip..

2.1 | BAZA E TË DHËNAVE PËR PËRFITUESIT E NDIHMËS EKONOMIKE

Teksti i angazhimit:

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në bashkëpunim të ngushtë me Shërbimin Social Shtetëror, në kuadër të reformës për zbutjen e varfërisë, rritjen e transparencës, cilësisë së shërbimit dhe përdorimit efektiv të fondeve buxhetore dhe përjashtimin e rasteve abuzive në skemën e ndihmës ekonomike, ka ndërmarrë nismën për krijimin e Regjistrit Kombëtar Elektronik të Përfituesve të Ndihmës Ekonomike.

Administrimi i ndihmës ekonomike është penguar nga mangësitë në kapacitete, mungesa e sistemit të informacionit, mbikëqyrjes dhe kontrollit. Shqipëria aktualisht nuk ka regjister kombëtar elektronik të kërkuesve të ndihmës ekonomike dhe marrja e ndihmës ekonomike administrohet në nivel vendor me dokumentacionin në formë letrë. Kjo rrjedhimisht çon në (a) mungesë efikasiteti në aplikimin dhe dhënien e përfitimeve (kostot më të larta të transaksioneve), (b) dobësitë në mbikëqyrjen dhe kontrollin për mashtrime dhe gabime, dhe (c) monitorimin dhe vlerësimin e politikave joefektive sociale.

Zbatimi i sistemit të ri do të ndihmojë në përmirësimin e efektivitetit të Shërbimit Social Shtetëror duke identifikuar familjet në nevojë, do të përmirësojë vlerësimin e përfituesve nga familjet aplikante dhe do të përjashtojë rastet abuzive në skemën e ndihmës ekonomike.

Institucioni përgjegjës: Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Institucion(et) mbështetës(e): Shërbimi Social Shtetëror

Data e fillimit: 2014

Data e mbarimit: 2016

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN PQH (siç është shkruar)				NDIKIMI I MUNDSHËM				PËRFUNDIMI		AFATMESËM		A MUNDËSOI QEVERISJE TË HAPUR?				
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Aksesi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësioi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
			X		E paqartë						X							X			
															X						

SYNIMI I ANGAZHIMIT:

Angazhimi synon të përmirësojë efektivitetin e skemës së asistencës sociale në Shqipëri duke krijuar Regjistrin Kombëtar Elektronik të Përfituesve të Ndihmës Ekonomike.

Regjistri është pjesë e Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale për Shqipërinë, një nisme e përbashkët e Bankës Botërore në Shqipëri dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR). Në vitin 2013 regjistri u pilotua në Tiranë, Durrës dhe Elbasan.

Kjo nismë e rëndësishme mundëson më shumë efikasitet në ndihmën ekonomike, zvogëlim të barrës administrative dhe shkurtim të procesit të aplikimit për përfituesit. Megjithatë, sistemi është për përdorim të brendshëm të qeverisë.

STATUSI

Periudha afatmesme: Konsiderueshëm

Raporti i vetëvlerësimit i qeverisë thotë se ky angazhim është përfunduar. Megjithatë, në harkun kohor prej një viti, regjistri nuk ishte plotësisht funksional. Deri në korrik 2015, MMSR dhe Shërbimit Social Shtetëror po monitoronin zbatimin e sistemit në qarqet pilote. U morën masa për të shtrirë lidhjet me bazat e të dhënave të institucioneve të tjera shtetërore dhe për të përfshirë module shtesë, si regjistri elektronik për personat me aftësi të kufizuara. Regjistri pritej të vihet plotësisht në funksion në të gjithë vendin pas vitit 2016.¹

Afati përfundimtar: Substancial

Zbatimi i regjistrimit ka bërë përpara gjatë 2016 sipas Projektit të Modernizimit të Ndhmës Ekonomike. Raporti më i fundit i ndërmjetëm i Bankës Botërore për këtë projekt e vlerëson zbatimin e tij si disi të kënaqshëm për shkak të "vonesave në zbatimin e disa aktiviteteve kryesore."²

Në prill 2015, Kuvendi miratoi ndryshimet në Ligjin "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" (2005), ndryshime që kishin të bënin me kriteret dhe procedurat për ndihmën ekonomike. Sipas raportit të ndërmjetëm të vetëvlerësimit të qeverisë (shtator 2016), sistemi ka pesë module, është zbatuar plotësisht në tre qarqet pilote dhe është i ndërlidhur me tetë institucione shtetërore, përfshirë këtu organet tatimore dhe shërbimin e punësimit. Deri në fund të vitit 2016, regjistri pritet të zbatohet në nëntë qarqet e mbetura të Shqipërisë. Projekti i Bankës Botërore, që financon këtë regjistrim, përfundon në qershor 2017.

A MUNDËSOI QEVERISJEN E HAPUR?

Regjistri Kombëtar Elektronik i Përfituesve të Ndhmës Ekonomike nisi nga puna në tre qarqe të Shqipërisë në qershor 2014. Sistemi ndihmon në vlerësimin e aplikimeve, dhe në procesin e kontrollit dhe verifikimit. Po ashtu, sistemi ndihmon edhe në pagesat elektronike. Regjistri është i ndërlidhur me bazat e tjera të të dhënave të qeverisë, të tilla si bazën e të dhënave të regjistrimit civil, sigurimet shoqërore, shërbimin shtetëror të punësimit, regjistri i pasurive të paluajtshme, qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve, për të vlerësuar aplikimet. Dixhitalizimi i sistemit të ndihmës ekonomike ka shërbyer për të ulur numrin e abuzimeve. Megjithatë, në media janë raportuar disa raste të përrjashtimit të padrejtë nga ndihma ekonomike. Raporti Vjetor 2014 i Avokatit të Popullit paraqiti në total 184 ankesa individuale apo në grup në lidhje me ndihmën ekonomike, duke përpiluar edhe një rekomandim për MMSR.³

Regjistri është një mjet i rëndësishëm që promovon politika sociale efikase dhe të bazuara në evidenca. Megjithatë, siç theksohet edhe në raportin e ndërmjetëm MRP (shtator 2015), regjistri nuk përfshin elementë që promovojnë transparencën, pjesëmarrjen, aksesin tek informacioni, apo llogaridhënien publike. Nuk ka të dhëna që, në mënyrën e zbatimit të tij, ky angazhim të ketë përçuar vlerat bazë të PQH.

PËRCJELLË MË TEJ?

Ky angazhim nuk është mbartur për planin tjetër të veprimtimit.

¹ Progres Raporti MRP, http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_Second%20IRM%20Report_for%20public%20comment.pdf.

² Banka Botërore, Projekti i Modernizimit të Ndhmës Ekonomike, <http://documents.worldbank.org/curated/en/137141468008128435/Albania-Social-Assistance-Modernization-Project-P122233-Implementation-Status-Results-Report-Sequence-07>.

³ Raport Vjetor Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit, <http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/RAPORTI%202014.pdf>.

3.2 | GJEOPORTALI KOMBËTAR

Teksti i angazhimit:

Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike, në bashkëpunim me Autoritetin Shqiptar për Informacione Gjeohapësinore do të ndërmarrë krijimin e një Gjeoportali Kombëtar Elektronik, i cili, për herë të parë do t'u sigurojë qytetarëve dhe institucioneve informacion transparent dhe të saktë gjeohapësinor. Nëpërmjet hartografimit të Gjeoportali Kombëtar qytetarët dhe aktorët e interesuar mund të hyjnë në hartat topografike, ortofoto, harta kufitare, harta treguese të pasurive të patundshme, dhe hartat e vlerës së pronës. Disa nga hapat që do të matin realizimin e këtij angazhimi janë: koordinimi ndërinstitucional për të mundësuar mbledhjen e të dhënave ekzistuese, përgatitjen e termave të referencës për infrastrukturën me programet dhe pajisjet kompjuterike të nevojshme për realizimin e këtij angazhimi, përgatitjen e modelit të të dhënave për informacioni gjeohapësinor, faqja paraprake online e gjeoportali që do të vërë në dispozicion informacionin ekzistues, përgatitja e informacionit të ri gjeohapësinor. Informacion mbi pronën dhe vlerën e tokës, pozicionimi dhe hartat kufitare me të dhënat përkatëse janë për momentin shumë të vështira për t'u mbledhur nga qytetarët. Po ashtu, niveli i korrupsionit në këtë fushë ka qenë shumë i lartë për një kohë të gjatë. Nëpërmjet zbatimit të këtij angazhimi do të kontribuohet në lehtësimin e aksesit tek hartat gjeohapësinore dhe tek të dhënat në një portal të vetëm.

Shënim redaksional: angazhimi përshkruan "disa hapa" për zbatimin e tij:

- Bashkëndim mes agjencive për të mundësuar mbledhjen e të dhënave ekzistuese
- Përgatitja e termave të referencës për infrastrukturën me programet dhe pajisjet kompjuterike të nevojshme për realizimin e këtij angazhimi
- Përgatitja e modelit të të dhënave për informacioni gjeohapësinor,
- Faqja paraprake online e gjeoportali do të vërë në dispozicion informacionin ekzistues,
- Përgatitja e informacionit të ri gjeohapësinor

Institucioni përgjegjës: Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike; Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)

Institucion(et) mbështetës(e): NA

Data e fillimit: 2014

Data e mbarimit: 2016

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN POH (siç është shkruar)				NDIKIMI I MUNDSHËM				PËRFUNDIMI		AFATMESËM		A MUNDËSOI QEVERISJE TË HAPUR?				
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Aksesi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësioi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
Në tërësi				X	X		X			X				X					X		

SYNIMI I ANGAZHIMIT:

Angazhimi synon të ofrojë informacion transparent dhe të saktë gjeohapësinor dhe shërbimet përkatëse. Portali është zhvilluar dhe menaxhohet nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), i krijuar në vitin 2013.

Krijimi i gjeoportalit kombëtar është detyrim i ligjit të miratuar në qershor 2012. Qeveria nisi zhvillimin e portalit në 2013 nëpërmjet një granti nga qeveria norvegjeze me shumën 1.2 milionë euro dhe me asistencë teknike nga Autoritetit Norvegjez të Hartografimit. Në kohën e miratimit të planit të veprimit (qershor 2014), Gjeoportali ishte tashmë në versionin beta, edhe pse popullimi i tij me të dhëna ishte ende në rrugë e sipër.

STATUSI

Periudha afatmesme: I kufizuar

Gjatë vitit 2015 aktivitetet e ASIG lidhur me Gjeoportalin Kombëtar u fokusuan tek popullimi i tij me të dhëna të reja, si Censusi i vitit 2015, informacion për institucionet arsimore, rrugët, gjeologjinë, zonat e mbrojtura, vlera e pronës, ndarja territoriale, kadastrat, hartat topografike, dhe ortofotot. Deri në shtator 2015, janë të ofruara falas në Gjeoportali rreth 40 shërbime për institucionet dhe publikun e gjerë.¹

Edhe pse është bërë progres në publikimin e informacionit, duhet më shumë punë që Gjeoportali të përmbushë standardet e Direktivës INSPIRE (Infrastruktura për Informacionin Hapësinor në Komunitetin Evropian). Kjo direktivë ka për qëllim të krijojë infrastrukturën e të dhënave hapësinore të Bashkimit Evropian, gjë që do të mundësojë shkëmbimin e informacionit hapësinor mjedisor mes institucioneve të sektorit publik dhe do të lehtësojë edhe më shumë aksesin e publikut tek informacionit hapësinor në të gjithë Evropën.

Afati përfundimtar: Konsiderueshëm

Procedurat e tenderit për softuerin e gjeoportalit u hapën në dhjetor 2015, pas përgatitjes së termave të referencës për softuerin dhe harduerin.² Gjatë vitit 2016 qeveria kontraktoi një kompani softuerësh për të krijuar gjeoportalin kombëtar në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 72/2012 dhe Direktivën INSPIRE. Objektivat e tjerë teknikë të nevojshëm për funksionimin e gjeoportalit kanë qenë kryesisht në rrugën e duhur dhe vazhdojnë sipas qëllimeve të gjeoportalit.

Deri në tetor 2016, gjeoportali ofronte 54 shërbime, përfshirë ndarjen administrative, hartat topografike, përshkrimin e përshtatshëm të tokës, një inventar të zonimit dhe zonave të mbrojtura dhe hartat e infrastrukturës rrugore.³

A MUNDËSOI QEVERISJEN E HAPUR?

Aksesi tek informacioni: i vogël

Ky angazhim është shumë i rëndësishëm me vlerat PQH dhe fazat e tij të avancuara të zbatimit mund të kenë ndikim të madh, në mos transformues. Informacioni dhe shërbimet e ofruara përmes këtij Gjeoportali përfaqësojnë një moment të rëndësishëm për të dhënat e hapura, reformat e qeverisjes transparente dhe përqasja e marrjes së vendimeve bazuar në evidencë. Gjithsesi, kjo do të kërkojë bashkërendimin e duhur mes institucioneve përkatëse shtetërore si dhe kuadrin e nevojshëm strategjik të planifikimit dhe monitorimit.

Në fund të periudhës së zbatimit të angazhimit, gjeoportali ka pasur një efekt pozitiv për rritjen e aksesit tek informacioni gjeohapësinor. Në periudhën nga qershori 2014 në qershor 2016, qeveria qendrore ka populluar portalin me të dhëna të reja dhe sipas shifrave të dhëna nga përfaqësuesit e ASIG, numri i vizitorëve gjatë periudhës gusht 2015-gusht 2016 arriti në 141,129 (rreth 11,700 vizitorë në muaj). Përdoruesit kryesorë janë institucionet shtetërore por edhe firma private dhe qytetarë.⁴

PËRCJELLË MË TEJ?

Ky angazhim nuk është mbartur për planin tjetër të veprimit 2016–2018. Përveç përditësimit të gjeoportalit me të dhëna dhe shërbime të reja, qeveria mund të promovojë përdorimin e tij nga publiku i gjerë. Këtu përfshihet komunikimi me median, shoqërinë civile, dhe botën akademike, përdorues të rëndësishëm të cilët mund të analizojnë më tej informacionin publik dhe t'i kërkojnë llogari institucioneve.

¹ Progres Raporti MRP, http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_Second%20IRM%20Report_for%20public%20comment.pdf.

² Njoftimi për tender gjendet në adresën <https://doffin.no/en/Notice/Details/2016-044438>.

³ Gjeoportali gjendet në [http://geoport.al/\(X\(1\)S\(fd04sigwdzqk0ns0p4cfdttv\)\)/Map.aspx?lang=AL](http://geoport.al/(X(1)S(fd04sigwdzqk0ns0p4cfdttv))/Map.aspx?lang=AL).

⁴ Informacioni i paraqitur me email, 18 tetor 2016.

4.2 | ZYRAT E SHËRBIMIT POLICOR

Teksti i angazhimit:

Qeveria shqiptare me synim sigurimin dhe lehtësimin e aksesit tek Shërbimi Policor do të ngrejë “zyra me një ndalesë (sportelet unike)” në çdo drejtori policie me qëllim: krijimin e një sporteli të unifikuar të pritjes për të gjitha shërbimet e ofruara, thjeshtimin e procedurave dhe kufizimin e numrit të dokumenteve që do të paraqiten. Zyrat me një ndalesë do të përmirësojnë dhe do të bëjnë më efikas edhe bashkëpunimin polici-komunitet duke ndihmuar në krijimin e një komuniteti më të sigurt dhe në rritjen e pjesëmarrjes së publikut. Aktualisht drejtoritë rajonale të policisë janë zona të mbyllura, ku qytetarët kanë shumë pak ose aspak akses. Ky angazhim ka për qëllim hapjen e shërbimeve policore për qytetarët duke u ofruar këtyre të fundit jo vetëm akses por edhe një shërbim më transparent, në kohë, duke shmangur kështu burokracinë dhe korrupsionin. Ofrimi i shërbimeve për qytetarët nëpërmjet këtyre zyrave do të rrisë besimin e tyre tek policia si dhe do të ndikojë në parandalimin e korrupsionit tek policia. Rivendosja e komunikimit me publikun, përmes ofrimit të shërbimeve administrative dhe procedurale, synohet që të arrihet me anë të regjistrimit elektronik të nevojave dhe kërkesave të tyre, dhe përcjellja e tyre, së bashku me dokumentacionin përkatës në zyrën e shqyrtimit dhe zgjidhjen e problemit brenda koha, siç është planifikuar. Zyrat e Shërbimit Policor do të ngrihen dhe funksionojnë në të gjitha strukturat policore, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë tek drejtoritë e policisë dhe komisariatet në rrethe, të cilat do të kenë mjedise të hapura për publikun dhe do të funksionojnë 24 orë pa pushim, me sportele, për shërbimin administrativ dhe procedural. Numri i zyrave të shërbimit të policisë që do të jenë të hapur, numri i shërbimeve që do të jenë në dispozicion për qytetarët, dhe numri i qytetarëve të shërbyer do të përdoren si tregues për të verifikuar zbatimin e këtij angazhimi.

Shënim redaksional: Përshkrimi i këtij angazhimi shtjellon një sërë veprimesh specifike që mund të kategorizohen në dy objektiva të rëndësishëm, si më poshtë:

1. Ngritja e një zyre me një ndalesë (me shërbim sporteli 24 orë në 7 ditë të javës) në çdo drejtori policie
 - a. Një sportel unik për të gjitha shërbimet e ofruara duke funksionuar me procedura të thjeshtësuara;
2. Regjistrimi elektronik i nevojave dhe kërkesave të qytetarëve dhe përcjellja e tyre tek zyra përkatëse.

Institucioni përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Institucion(et) mbështetës(e): NA

Data e fillimit: 2014

Data e mbarimit: 2016

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN PQH (siç është shkruar)				NDIKIMI I MUNDSHËM				PËRFUNDIMI		AFATMESËM		A MUNDËSOI QEVERISJE TË HAPUR?				
	Nuk ka	I uliët	Mesatar	I lartë	Aksesi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përqësioi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
Në tërësi				X	X	X	X			X					X			X			

SYNIMI I ANGAZHIMIT:

Ky angazhim ka për qëllim përmirësimin e shërbimeve policore ndaj qytetarëve. Zyrat e Shërbimit të Policisë duhet të shërbejnë si zyra me një ndalesë për qytetarët. Ato janë projektuar për të thjeshtuar procedurat dhe për të kufizuar numrin e dokumenteve që duhet të paraqesin qytetarët. Infrastruktura e sofistikuar e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), përfshirë këtu aplikacionin që mundëson monitorimin e të gjithë procesit të ofrimit të shërbimit, ndihmon zyrat dhe promovon transparencën.

Ky angazhim përbën një hap të rëndësishëm drejt rritjes së besimit të publikut duke i bërë shërbimet e policisë më të hapura e më efikase.

STATUSI

Periudha afatmesme: Konsiderueshëm

Deri në shtator 2015, Zyrat e Shërbimit Policor ishin hapur në nëntë nga gjithsej dymbëdhjetë drejtori rajonale të policisë në vend. Gjatë vitit 2015, aplikimi për regjistrimin elektronik të kërkesave të qytetarëve është zhvilluar dhe testuar në disa nga zyrat e krijuara për disa shërbime, të tilla si deklaratat për humbje dokumenti dhe autorizimet për armët e gjuetisë. Bazuar në këtë testim, ka pasur përmirësime të mëtejshme të aplikacionit. Raporti i ndërmjetëm MRP konstatoi se ky angazhim rezultoi me nisma të tjera përtej planit origjinal. P.sh., policia ndërmori hapa novatorë, si prezantimi i aplikacionit “Komisariati dixhitale” për të nxitur veprimin qytetar. Ky aplikacion u bën të mundur qytetarëve të raportojnë në mënyrë proaktive korrupsionin dhe aktivitetet e tjera të paligjshme në kohë reale tek Policia e Shtetit.¹

Afati përfundimtar: Konsiderueshëm

Sipas raportit përfundimtar të vetëvlerësimit të qeverisë (shtator 2016), u hapën 20 zyra të shërbimit për qytetarët në drejtoritë vendore të policisë në Tiranë, Lezhë, Berat, Vlorë, Korçë, Fier, Kukës, Durrës, Elbasan, Shkodër, Dibër, Gjirokastrë, Pogradec, Lushnjë, dhe Kavajë. Hulumtuesi i MRP i verifikoi dhe konfirmoi hapjen e këtyre zyrave të shërbimit qytetar.² Po ashtu, është bërë progres i madh në regjistrimin elektronik të kërkesave dhe nevojave të qytetarëve. Aplikacioni për regjistrimin elektronik është zhvilluar plotësisht dhe zbatuar në të gjitha drejtoritë e qarqeve.³ Megjithatë, jo i gjithë aplikacioni funksionon siç duhet dhe ka nevojë për investime të mëtejshme në infrastrukturën TIK.

A MUNDËSOI QEVERISJEN E HAPUR?

Aksesi tek informacioni: I vogël

Llogaridhënia publike: Nuk ndryshoi

Zyrat me një ndalesë u ofrojnë qytetarëve akses më të mirë tek shërbimet e policisë dhe janë projektuar të thjeshtojnë procedurat, si marrja e lejeve apo pasaportat. Këto zyra u kanë bërë të mundur qytetarëve të marrin informacione për dokumentet zyrtare dhe lejet, informacion që më parë i vihej në dispozicion publikut por në një gjuhë më pak të kuptueshme në Fletoren Zyrtare apo në faqen në internet të Policisë së Shtetit. Nga ana tjetër, softueri që përdoret në zyrat e policisë është krijuar vetëm për procedura të brendshme dhe deri në shtator 2016 nuk kishte mekanizma që qytetarët të vlerësonin shërbimet e zyrave të policisë. Prandaj, ky angazhim nuk ka sjellë ndryshime në përmirësimin e llogaridhënies publike.

Pavarësisht përmirësimeve dhe reformave në vitet e fundit, korrupsioni në polici përbën ende një shqetësim serioz.⁴ Gjetjet paraprake të një studimi të vitit 2016 të kryer nga IDM për integritetin dhe korrupsionin policor në Shqipëri evidentojnë se korrupsioni mbetet në nivele serioze dhe i përhapur në Policinë e Shtetit.⁵ Ekspertë të pavarur argumentojnë se angazhimi duhet të shoqërohet me masa më të plota monitorimi dhe kërkesë llogarie.⁶ Disa nga masat konkrete janë vlerësimi i menjëhershëm i qytetarëve për shërbimin në zyrat e shërbimit policor

dhe analiza që i vihen në dispozicion publikut për treguesit e performancës (d.m.th., numri i ankesave/kërkesave të paraqitura dhe të përpunuara në zyrat e shërbimit policor, koha mesatare e përpunimit dhe lista e kërkesave më të shpeshta për shërbime).

PËRCJELLË MË TEJ?

Ky angazhim nuk është mbartur për planin tjetër të veprimit 2016–2018. Në raportin e ndërmjetëm të MRP 2014–2015 rekomandoheshin një sërë veprimesh që nëse do të zbatoheshin do të kishin një ndikim të madh në hapjen e qeverisë. Disa nga masat përfshinin partneritetin me organizatat e shoqërisë civile apo ato komunitare për të monitoruar performancën e zyrave të shërbimit të policisë dhe prezantimin e instrumenteve të vlerësimit anonim për qytetarët që vizitojnë këto zyra.

¹ Progres Raporti MRP, http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_Second%20IRM%20Report_for%20public%20comment.pdf.

² Përrurimi i zyrave me një ndalesë (2015–2016), <http://www.punetebrendshme.gov.al/al/te-rejat/lajme/celen-zyrat-e-sherbimit-unik-per-qytetaret-ne-korce-e-pogradec-video>, <https://www.asp.gov.al/index.php/component/content/article/17-shqip/lajmet-e-fundit/9078-inaugurimi-i-zyrave-te-sherbimit-per-qytetaret-ne-komisariat-in-e-policise-nr-5-ne-kamez>, <https://www.asp.gov.al/index.php/component/content/article/275-slideshow-home/8159-inagurohet-zyra-e-sherbimit-unik-per-qytetaret-ne-kom-3-ne-tirane>, <https://www.asp.gov.al/index.php/component/content/article/275-slideshow-home/7347-elbasan-hapen-zyrat-e-sherbimit-per-qytetaret>, <http://www.punetebrendshme.gov.al/al/te-rejat/lajme/ministri-tahiri-inauguron-komisariat-in-dhe-zyren-e-sherbimeve-ne-lushnje>, <http://www.punetebrendshme.gov.al/al/te-rejat/lajme/lezhe-inagurohet-zyra-e-sherbimit-unik-ne-drejtorine-vendore-te-policise>.

³ Intervistë me zyrtar të Ministrisë së Punëve të Brendshme, shtator 2016.

⁴ Komisioni Evropian, Progres raporti i Shqipërisë, tetor 2014, p. 2. www.bit.ly/1BQGIgC.

⁵ Intervistë me ekipin hulumtues të IDM për "Indeksin e Integritetit të Policisë", tetor 2016.

⁶ Intervista me ekspertë të shoqërisë civile dhe një diskutim në fokus grup, shtator 2015.

GRUPI 1 | DENONCIMI I KORRUPSIONIT

Shënim redaksional: Ky grup (C. 1) ndërthur dy angazhime individuale që kanë të bëjnë me legjislacionin dhe aktet nënligjore në luftën kundër korrupsionit.

Angazhimi 1.1. Standardizimi i ankesave për korrupsionin

Teksti i angazhimit 1.1:

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, në rolin e Koordinatorit Kombëtar për Anti-Korrupsionin, do të ndër marrë standardizimin e procesit në lidhje me ankesat që trajtojnë korrupsionin. Aktualisht, edhe pse shumë ministri kanë ngritur linjën e gjelbër ose forma të tjera për të denoncimin e korrupsionit, nuk ka ende një procedurë të standardizuar, që të sigurojë transparencë në shqyrtimin e ankesës dhe afatet konkrete për të siguruar një shërbim të mirë. Disa nga treguesit dhe objektivat e përcaktuara për këtë angazhim janë hartimi i udhëzimeve përkatëse për trajtimin e ankesave të korrupsionit, integrimin e tyre në një plan rregullash për transparencën në çdo ministri, publikimin e tyre online. Duke pasur parasysh specifikat dhe vështirësitë e luftës dhe hetimit të korrupsionit, ky sistem, nëpërmjet standardizimit të proceseve, mund të rrisë besimin tek administrata dhe të rrisë numrin e informatorëve. Ministrinë do të duhet të publikojnë zyrtarisht standardet përkatëse dhe të informojnë publikun për ecurinë e çështjeve të veçanta, duke rritur nivelin e përgjegjshmërisë së administratës publike. Ky angazhim do të ndihmojë në përmirësimin e transparencës në lidhje me procedurat e ankimit. Në fakt, deri më tani nuk ka asnjë informacion të qartë se si mund të trajtojë një ankesë në rastet e korrupsionit qytetari. Publikimi i këtyre "standardeve" jo vetëm që do të krijojë uniformitet në mënyrën e trajtimit të ankesave, por do të shërbejë edhe për rritjen e efikasitetit të administratës publike në trajtimin e ankesave për korrupsion.

Institucioni përgjegjës: Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore (MSHÇV)

Institucionet mbështetëse: Ministrinë, Kuvendi

Data e fillimit: 2014

Data e mbarimit: 2016

Angazhimi 4.1. Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve

Teksti i angazhimit 4.1:

Aktualisht, besimi i publikut tek administrata publike është i ulët, ndërsa rreziku me të cilin do të përballet informator kur denoncon rastet e korrupsionit është shumë i lartë. Në Shqipëri, nuk ka një kuadër të qartë që të sigurojë bashkëpunimin me informatorët dhe të mbrojë sinjalizuesit (informatorët). Ky ligj, së bashku me fushatën sensibilizuese që do të pasojë, do të sigurojë që informatorët që do t'i besojnë agjencive të zbatimit duke i dhënë atyre informacion në lidhje me korrupsionin në sektorët ku punojnë apo janë të përfshirë, do të kenë mbrojtje. Ky ligj do të rrisë jo vetëm transparencën dhe raportimin e rasteve të korrupsionit, por edhe besueshmërinë e administratës. Aktualisht ekziston një projektligj, i cili për momentin është në konsultim. Ligji është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Korrupsionit 2014-2017, e cila parashton të dy objektiva: parandalim dhe ndërgjegjësim. Për më tepër, miratimi i ligjit është pjesë e angazhimit për Prioritetin Nr. 3 të udhërrëfyesit për luftën kundër korrupsionit në kuadër të integritetit të Shqipërisë në BE. Do të ketë një konsultim të gjerë me agjencitë qeveritare dhe donatorët, ndërsa janë planifikuar edhe takime konsultimi me shoqërinë civile dhe sektorin e biznesit. Pas këtyre konsultimeve, drafti do të redaktohet për të reflektuar komentet, dhe pas konsultimeve të mëtejshme të brendshme dhe të jashtme, ligji pritet të përfundojë në vjeshtë dhe të miratohet para mbylljes së këtij viti.

Institucioni përgjegjës: Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore (MSHÇV)

Institucionet mbështetëse: Ministrinë, Kuvendi

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN POH (siç është shkruar)				NDIKIMI I MUNDSHËM				PËRFUNDIMI		AFATMESËM		A MUNDËSOI QEVERISJE TË HAPUR?				
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Aksesi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	PËRFUNDIMTAR		E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
															I konsiderueshëm	I përfunduar					
1.1. Standardizimi i ankesave për korrupsionin			X			X				X					X				X		
4.1. Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve				X		X					X		X						X		

SYNIMET E ANGAZHIMEVE:

Shumë organizata të shoqërisë civile kanë ngritur shqetësime për standardizimin e procedurës së ankesave kundër korrupsionit dhe për Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve. Të dy angazhimet janë aktualisht pjesë e Strategjisë Anti-Korrupsion të Shqipërisë 2015-2020 dhe planit të saj të veprimit 2015-2017.

Angazhimi 1.1 synon të standardizojë procedurën e ankesave për korrupsionin nëpërmjet krijimit dhe operimit të një portali online për raportimin e rasteve të korrupsionit. Në këtë angazhim përfshihet edhe publikimi i rregullave të transparencës në çdo ministri.

Angazhimi 4.1 synon të finalizojë miratimin e projektligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve, gjë që do të ndihmojnë në luftën kundër korrupsionit në sektorin publik.

STATUSI

Angazhimi 1.1

Periudha afatmesme: Konsiderueshëm

Më 5 mars 2015, Kryeministri nxori urdhrin për miratimin e rregullores për procedurat e regjistrimit, shqyrtimit dhe ruajtjes së ankesave ndaj praktikave korruptive. Këto rregullore dhe procedura janë integruar tashmë në faqen denoncimit të korrupsionit (www.stop.korrupsionit.al). Portali u inaugurua në shkurt 2015 dhe u bën të mundur qytetarëve të denoncojnë online ankesa kundër korrupsionit dhe të ngarkojnë në portal fakte, si foto, video apo dokumente. Qytetarët mund të zgjedhin që të bëjnë të ditur identitetin e tyre ose të mbeten anonimë.

Nga vlerësimi afatmesëm, shumë ministri nuk kishin publikuar programet e tyre të transparencës, regjistrin e kërkesave dhe përgjigjet e tyre. Vetëvlerësimi i qeverisë thotë se ky angazhim është zbatuar. Megjithatë, ai nuk tregon numrin e institucioneve qendrore që kanë integruar rregullat dhe standardet e transparencës deri në fund të periudhës së raportimit.¹

Afati përfundimtar: I përfunduar

Deri në 30 qershor 2016, portali anti-korrupsion ka pasur rreth 9,900 vizita gjatë vitit 2016, me 14,410 raportime të bëra që në hapjen e tij. Nga 14,410 raste, 6,330 u zgjidhën, 6,260 u refuzuan, dhe 1,037 ishin në proces shqyrtimi. Koha mesatare e procesit të shqyrtimit për ankesë është 16 ditë.²

Në fund të periudhës së zbatimit, të gjitha ministritë kishin publikuar programet e transparencës³, duke përfshirë të gjitha kategoritë e informacionit në dispozicion të publikut. Përveç këtij programi, të gjitha ministritë kanë publikuar edhe informacione për koordinatorët për të drejtën e informimit dhe regjistrin e kërkesave për informacion.

Angazhimi 4.1

Periudha afatmesme: I kufizuar

Afati përfundimtar për miratimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve u shty nga fundi i vitit 2014 në mes të 2015. Sipas Planit të Veprimit 2015-2017 të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020, zbatimi i masave të tjera që lidhen me këtë ligj (p.sh., miratimi i akteve nënligjore dhe krijimi dhe forcimi i strukturave shtetërore për zbatim), pritet të përfundojnë deri në fund të vitit 2016.⁴

Afati përfundimtar: I përfunduar

Në qershor 2016, Kuvendi miratoi Ligjin "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" (Fletore Zyrtare Nr. 115, 23 qershor 2016). Ligji hyri në fuqi më 8 korrik 2016. Në kohën që po hartohet ky raport përfundimtar, qeveria po hartonte aktet nënligjore dhe aktet e tjera përkatëse. Me mbështetje të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës, Partnerët Shqipëri, një organizatë e shoqërisë civile me qendër në Tiranë, po realizonte një fushatë kombëtare ndërgjegjësimi dhe një seri tryezash të rrumbullakëta për zbatimin e ligjit.

A MUNDËSOI QEVERISJEN E HAPUR?

Angazhimi 1.1

Llogaridhënia publike: I vogël

Përfaqësues të shoqërisë civile ngritën shqetësimin për përgjigjet nga qeveria ndaj ankesave të qytetarëve që janë bërë nëpërmjet portalit. Në vitin 2015, OSHC-të sugjeruan se në mungesë të informacionit në lidhje me "çfarë ndodhi pas raportit të bërë dhe çfarë masash konkrete u morën", publiku mund të humbiste interes dhe madje edhe të bëhej skeptik për këto mjete.⁵ Për të përmirësuar transparencën dhe aksesin në informacion, portali ka shtuar seksionin "Statistika" (<http://stat.stopkorrupsionit.al/>). Numri i raporteve të paraqitura ka rënë ndjeshëm në vitin 2016. Shifrat ranë nga 7,000 raportime në gjysmën e parë të 2015 (gjashtë muaj) në më pak se 3,000 në periudhën korrik 2015 - shtator 2016 (thuajse 15 muaj). Që nga shtatori 2016, portali nuk ka dhënë asnjë informacion mbi rezultatet e raportimeve të zgjidhura.

Angazhimi 4.1

Llogaridhënia publike: I vogël

Ky angazhim ka një ndikim të mundshëm të konsiderueshëm për t'iu bërë të mundur punonjësve të sektorit publik të denoncojnë korrupsionin.⁶ Megjithatë, ligji është i ri dhe është shumë herët për të parë ndonjë rezultat konkret që të ndikojë në llogaridhënien publike. Gjithsesi, qeveria qendrore ka treguar shenja të zbatimit të ligjit. P.sh., në korrik 2016, MSHÇV, ILDKPKI dhe Partnerët Shqipëri nënshkruan një memorandum bashkëpunimi që është edhe hapi i parë i një fushate intensive ndërgjegjësimi për zyrtarët publikë.

OSHC e intervistuar për këtë raport e shohin miratimin e ligjit si pozitiv, por vënë re se suksesi i tij dhe ndikimi konkret i këtij ligji do të varen kryesisht nga reforma në gjyqësor që po ndërmerr aktualisht vendi.

PËRCJELLË MË TEJ?

Angazhimi për portalin anti-korrupsion nuk është mbartur për planin tjetër të veprimit 2016–2018. Gjithsesi, ky plan përfshin angazhimin për Ligjin “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, duke u fokusuar në forcimin e zbatimit të ligjit, në ngritjen e kapaciteteve dhe në ndryshimet e mëvonshme dhe aktet nënligjore.

¹ Progres Raporti MRP, http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_Second%20IRM%20Report_for%20public%20comment.pdf.

² Portali anti-korrupsion, www.stopkorrupsionit.al.

³ Monitorimi nga MRP i faqeve zyrtare të ministrive në internet.

⁴ Progres Raporti MRP, http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_Second%20IRM%20Report_for%20public%20comment.pdf.

⁵ Progres Raporti MRP, http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_Second%20IRM%20Report_for%20public%20comment.pdf.

⁶ Aktorët e shoqërisë civile kanë konfirmuar këtë pritshmëri gjatë konsultimeve për projektligjin (2015) dhe, aktualisht, gjatë aktiviteteve të ndryshme ndërgjegjësuere për zbatimin e Ligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”

GRUPI 2 | TË DHËNAT E HAPURA DHE E-SHËRBIMET

Ky grup përbëhet nga dy angazhime, si më poshtë:

Angazhimi 1.3. Zbatimi i modulit të shpenzimeve publike në formatin “të dhëna të hapura”

Teksti i angazhimit 1.3:

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në kuadër të nismës globale “Partneritet për Qeverisje të Hapur”, do të ndërmarrë si angazhim zbatimin e një moduli që do të lejojë në një format të hapur të të dhënave qasje online për informacion mbi të dhënat buxhetore të ministrive. Ky modul do të aksesohet nga portali qeveritar e-Albania dhe faqet zyrtare të institucioneve përkatëse. Ai do të sigurojë informacion në kohë reale të shpenzimeve buxhetore të Këshillit të Ministrave dhe ministrive të linjës për të garantuar informacion të plotë dhe transparent të shpenzimeve. Treguesit e tillë si funksionaliteti i modulit, numri i vizitorëve të faqeve ose informacioneve të shkarkuara do të përdoren për të verifikuar zbatimin e këtij angazhimi.

Institucioni përgjegjës: MSIAP dhe AKSHI

Institucionet mbështetëse: Ministrinë

Data e fillimit: 2014

Data e mbarimit: 2016

Angazhimi 3.3. E-Albania

Teksti i Angazhimit 3.3:

Portali E-Albania shërben si një pikë e vetme kontakti për shërbime qeveritare, duke ndihmuar në përmirësimin e aksesit të përgjithshëm të informacionit për publikun. Platforma e Interoperabilitetit (ndërveprueshmërisë) mbi të cilën është bazuar ky portal mund të zgjerohet për shërbime të tjera thelbësore qeveritare. Deri tani, janë publikuar të dhëna për 170 shërbimet e ofruara nga administrata publike. Shërbime si aksesit tek të dhënat personale, të dhënat e biznesit, dhe deklarimi online i të ardhurat personale do të shtohen së shpejti si e-shërbime të ofruara nga portali. E-Albania do të pasurohet me e-shërbime të tjera të ndryshme publike. Qëllimi i këtij angazhimi është të kalojë nga shërbimet e nivelit të parë (shërbimet informuese) në nivelin e 3 dhe 4, që do të thotë shërbimet publike që ofrohen tërësisht online. Pritet që gjatë vitit 2015, të ofrohen 10 shërbime të reja tërësisht në internet dhe 10 të tjera do të shtohen në vitin 2016.

Shënim redaksional: Të dyja angazhimet do të zbatohet nga MSIAP dhe Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI). Përveç kësaj, publiku do të ketë akses tek rezultatet e tyre përmes portalit e-Albania-angazhimi i parë jep një “modul të shpenzimeve publike” me të dhëna të hapura dhe angazhimi i dytë zgjeron numrin e e-shërbimeve që aksesohen përmes portalit e-Albania.

Institucioni përgjegjës: MSIAP dhe AKSHI

Institucionet mbështetëse: Ministrinë

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN POH (siç është shkruar)			NDIKIMI I MUNDSHËM				PËRFUNDIMI		AFATMESËM		A MUNDËSOI QEVERISJE TË HAPUR?					
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Aksesi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	PËRFUNDIMTAR		E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
															I konsiderueshëm	I përfunduar					
1.3. Shpenzimet publike në formatin e të dhënave të hapura			X		X		X			X					X			X			
3.3. E-Albania			X		X		X			X					X				X		

SYNIMI I ANGAZHIMIT:

Nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit, këto angazhime kanë për qëllim të përmirësojnë aksesin në informacion në lidhje me shërbimet qeveritare. Konkretisht, moduli i shpenzimeve publike mundëson transparencën dhe përgjegjshmërinë e shpenzimeve të qeverisë. Nga ana tjetër, nisma e-Albania është projektuar si portal përmes të cilit qytetarët mund të aksesojnë informacione dhe mund të marrin shërbimet elektronike të ofruara nga institucionet shtetërore.

STATUSI

Angazhimi 1.3

Periudha afatmesme: Konsiderueshëm

Në vitin 2014 Këshilli i Ministrave nisi të shfaqë informacione për buxhetin nëpërmjet një moduli në faqen në internet. Moduli ka një format të dhënash të hapura dhe boton informacione për buxhetin nga Këshilli i Ministrave dhe ministritë. Në fund të periudhës së planit të veprimit, moduli ofronte informacione mbi të dhënat e shpenzimeve të qeverisë nga data 1 janar 2015. Megjithatë, informacioni mbi shpenzimet e qeverisë dhe të ministrive shfaqet si përqindje e buxhetit të tyre përkatëse dhe kjo nuk do të jepet në shifra reale të buxheteve. Vizitorët mund vetëm të aksesojnë informacionin e paraqitur, jo të dhëna të hapura, për qeverinë apo të një ministrie të veçantë, në total për 11 kategori shpenzimesh. Prandaj, moduli nuk i plotësoi kriteret për një standard 5-yjesh të të dhënave të hapur, siç parashikohet në Planin e Veprimit.

Ashtu siç është zbatuar, ky instrument plotësoi standardin me 2 yje të të dhënave të hapura. Ai siguroi akses tek të dhëna që mund të shkarkohen në format Excel-i nga pagesat e përditshme për 2014 dhe 2015 të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Të njëjtat të dhëna mund të merreshin në format të hapur edhe në portalin e-Albania.¹

Afati përfundimtar: I kufizuar

Gjatë periudhës shtator 2015 – shtator 2016 nuk është bërë asnjë përparim i mëtijshëm për zbatimin e këtij angazhimi. Qeveria nuk e përditësoi modulën me të dhënat për shpenzimet publike të 2016 dhe moduli është hequr që prej asaj kohe nga faqja zyrtare e Këshillit të Ministrave. Nga ana tjetër, Ministria e Financave përditëson rregullisht modulën në faqen e vet zyrtare me pagesat ditore nga Thesari.²

Vetëvlerësimi përfundimtar i qeverisë i referohet këtij angazhimi si i zbatuar, duke përdorur modulën e MF si evidencë. Megjithatë, ky modul nuk ishte pjesë e angazhimit 1.3 në planin e veprimit 2014-2016, por rezultat i prodhuar në planin e veprimit 2012-2013.

Angazhimi 3.3

Periudha afatmesme: Konsiderueshëm

Portali e-Albania ka rritur numrin e shërbimeve të ofruara nga 177 në vitin 2013 në një total prej 700 deri në shtator 2015. Megjithatë, shumica e këtyre shërbimeve kanë të bëjnë thjesht me “informacione dhe udhëzime” (shërbime të nivelit të parë) për shërbimet e ndryshme të institucioneve shtetërore që mund të përdorin qytetarët apo bizneset. Shërbimet me funksione interoperabiliteti, të cilat do të mundësonin shkëmbimin dhe përdorimin e informacionit, ishin të kufizuara.³

Afati përfundimtar: Konsiderueshëm

Portali e-Albania ka bërë përmirësime të konsiderueshme gjatë periudhës shtator 2015 – shtator 2016. Portalit i janë shtuar edhe 148 shërbime të reja që nga raporti i ndërmjetëm MRP, duke rritur numrin e shërbimeve nga 700 në shtator 2015 në 848 në shtator 2016. Edhe pse pjesa më e madhe e informacionit është kryesisht udhëzime për shërbimet shtetërore, numri i shërbimeve elektronike me funksione transaksionesh (niveli 3) dhe interoperabiliteti (niveli 5) ka arritur në total 278. Qeveria qendrore synon që portali të jetë porta kryesore e qytetarëve për marrjen e një sërë shërbimesh në rrugë elektronike. Për të realizuar këtë qëllim, institucionet e qeverisë po vazhdojnë të dixhitalizojnë më shumë shërbime.

A MUNDËSOI QEVERISJEN E HAPUR?

Angazhimi 1.3

Aksesi tek informacioni: Nuk ndryshoi

Moduli në faqet e qeverisë dhe ministrive nuk ofron informacione në format të dhënash të hapura dhe nuk është përdorur nga shoqëria civile apo përfaqësues të medias. Portali e-Albania përfshin modulën e MF si një nga e-shërbimet që mund të aksesohet pa qenë e nevojshme të regjistrohesh në portal.⁴ Publikimi i pagesave ditore nga MF, pavarësisht se plotëson standardin 3-yje të të dhënave të hapura, është përdorur më shpesh nga shoqëria civile dhe media (p.sh., Instituti Shqiptar i Shkencave dhe Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri – BIRN Albania - Reporter.al).

Pjesa më e madhe e përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe gazetarët të intervistuar raportuan se nuk kishin informacion për modulën e Këshillit të Ministrave ose nuk e shihnin si të dobishëm.⁵ Për më tepër, moduli më vonë u hoq nga faqja zyrtare. OSHC-të i konsiderojnë të dhënat për pagesat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në Ministrinë e Financave si mjet më i dobishëm.

Angazhimi 3.3

Aksesi tek informacioni: I vogël

Numri i përdoruesve unikë në e-Albania është rritur shumë, nga afro 18,000 përdorues në muaj në 2015 në 26,500 përdorues unikë në muaj në tetor 2016.⁶ Në E-Albania ofrohet më së shumti informacion për mënyrën e marrjes së shërbimeve të ndryshme nga institucionet shtetërore.

Të dhënat për përdorimin më të shpeshtë të shërbimeve tregojnë se ka më shumë interes për shërbimet e nivelit të dytë dhe të tretë në portal. Sipas të dhënave zyrtare të MSIAP, pesë shërbimet më të frekuentuara janë: dorëzimi bilanceve financiare vjetore tek QKR, regjistrimi për provimet e maturës⁷, pagesa e energjisë elektrike, aplikimi për kartën e shëndetit dhe prodhimi i kartës së shëndetit. Gama e përdoruesve, nga nxënës deri tek bizneset, të këtyre shërbimeve si dhe të shërbimeve të tjera⁸ sugjeron se forca e e-Albania gjendet tek funksionet e interoperabilitetit, që ndihmon njerëzit dhe bizneset të marrin shërbimet online.

PËRCJELLË MË TEJ?

Angazhimi 1.1 has nuk është mbartur për në planin e veprimit 2016–2018. Raporti i ndërmjetëm MRP sugjeron që moduli të rindërtohet për të përmbushur standardet e të dhënave të hapura, ose si alternativë, tërheqja nga ky angazhim dhe në vend të saj përqendrimi në portalin opendata.gov.al.

Angazhimi për portalin e-Albania është mbartur për në planin e veprimit 2016–2018. Angazhimet e reja zgjerojnë portalin e-Albania, duke ofruar shërbime të reja me funksionet e interoperabilitetit. Ky angazhim ka si synim të ofrojë shërbime elektronike nëpërmjet sistemit të menaxhimit të formularëve elektronikë (e-formular). Për më tepër, me këtë platformë janë të lidhura drejtpërdrejt edhe një sërë angazhimesh të tjera në planin e ri të veprimit, duke përfshirë krijimin e një regjistri elektronik për njoftimin publik dhe konsultimet (angazhimi 1.4), krijimi dhe shpërndarja e sporteve dixhitale (angazhimi 3.3), dhe sistem elektronik për licencimin profesional të personave fizikë dhe juridikë që veprojnë në sektorin e ndërtimit (angazhimi 4.2).

¹ Progres Raporti MRP, http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_Second%20IRM%20Report_for%20public%20comment.pdf.

² Burimi: <http://www.financa.gov.al/raportime/thesari/pagesa-te-kryera-nga-drejtoria-e-pergjithshme-e-thesarit>.

³ Progres Raporti MRP, http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_Second%20IRM%20Report_for%20public%20comment.pdf.

⁴ Burimi: <https://e-albania.al/MFtreasure.aspx>.

⁵ Intervista me Drejtoreshen e AIS, Aranita Brahaj, dhe me gazetare nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri (BIRN).

⁶ MSIAP paraqiti të dhënat zyrtare sipas kërkesës MRP (tetor 2016). Sipas këtyre të dhënave, e-Albania në periudhën qershor-dhjetor 2015 ka pasur gjithsej 126,000 vizitorë unikë që kanë përfunduar të paktën një seancë brenda portalit. Nga 1 janar deri më 20 tetor të vitit 2016, përfunduar të paktën një seancë në e-Albania në total 265,000 përdorues unikë.

⁷ Kërkesa për regjistrim online për provimet e shkollës së mesme, të njohura si Matura Shtetërore, filloi në fillim të vitit 2013. Maturantët e shkollave të mesme mund të përdorin shërbimin e Maturës Shtetërore të ofruar nga portali e-Albania për t'u regjistruar për provimet e maturës. Kjo gjë i bënte të mundur edhe institucioneve shtetërore, si Agjencisë Kombëtare të Provimeve dhe Ministrisë së Arsimit, të shkëmbejnë informacione për aplikimet në Maturën Shtetërore.

⁸ Shërbime të tjera të përdorura shpesh janë edhe njohja e rezultateve të Maturës Shtetërore, deklarimi dhe pagesa e kontributeve nga punëdhënësit, marrja e të dhënave familjare, aksesit tek "makinat e mia", dhe informimi për gjokat e policisë rrugore. MSIAP paraqiti të dhënat zyrtare sipas kërkesës MRP (tetor 2016).

GRUPI 3 | AKSES I HAPUR PËR TË DHËNAT E BURIMEVE NATYRORE

Ky grup përbëhet nga dy angazhimet, si më poshtë:

Angazhimi 2.2. Portali elektronik për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore

Teksti i angazhimit 2.2:

Palët e interesuara që aplikojnë për licencë apo autorizim për përdorimin e burimeve ujore përballen me një procedurë të komplikuar dhe të gjatë të aplikimit. Mungesa e një inventari kombëtar të lejeve për shfrytëzimin e burimeve ujore është, po ashtu, një disavantazh që shkakton konflikte mes aktorëve institucionalë dhe palëve të interesuara. Ministria e Mjedisit, nëpërmjet Drejtorisë së Politikave të Burimeve Ujore, do të ndërmarrë krijimin e një sistemi të integruar të menaxhimit të ujit që do të përmirësojë bashkëpunimin mes aktorëve publikë dhe privatë nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja për aplikimet e licencës dhe kontrollin. Ky sistem do të ndihmojë në rritjen e transparencës në përdorimin e burimeve ujore në Shqipëri. Ky angazhim kërkon të përmirësojë qeverisjen e burimeve natyrore për një menaxhim më të mirë të ujit, duke ulur rastet e korrupsionit, forcimin e ndërgjegjësimit publik për menaxhimin e ujit. Krijimi i një regjistri online të përdoruesve të burimeve ujore do të ndikojë pozitivisht në transparencën dhe aksesin e publikut tek informacioni.

Institucioni përgjegjës: Ministria e Mjedisit

Institucionet mbështetëse: N/A

Data e fillimit: 2014

Data e mbarimit: 2016

Angazhimi 3.1. Aksesi Elektronik tek Zonat e Mbrojtura

Teksti i angazhimit 3.1:

Aksesi elektronik tek regjistri i zonave të mbrojtura rrit pjesëmarrjen dhe përfshirjen e opinionit publik dhe aktorëve të interesuar për aktivitetet që lidhen me zonat e mbrojtura, zonave të gjuetisë dhe nismave kombëtare legjislative në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit. Aksesi tek portal do të mundësojë konsultimin e dokumenteve ligjore që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, një bazë të dhënash të zonave të reja të mbrojtura (ZM) ose zgjerimin e zonave ekzistuese, informacion mbi zonat e gjuetisë dhe hartat përkatëse dixhitale GIS. Krijimi i këtij portali do të kontribuojë fuqishëm në rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut; në fakt, portal do të mundësojë shkëmbimin ndërveprues të mendimeve rreth projektligjeve, rregulloreve dhe strategjive në fushën e zonave të mbrojtura.

Institucioni përgjegjës: Ministria e Mjedisit

Institucionet mbështetëse: N/A

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN POH (siç është shkruar)				NDIKIMI I MUNDSHËM				PËRFUNDIMI				AFATMESËM		A MUNDËSOI QEVERISJE TË HAPUR?					
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Aksesi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	PËRFUNDIMTAR		E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë	
2.2. Portali elektronik për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore			X		X									X										
3.1. Aksesi Elektronik tek Zonat e Mbrojtura		X			X	X	X			X				X						X				

SYNIMET E ANGAZHIMEVE:

Këto angazhime u propozuan nga anëtarë të shoqërisë civile në Shqipëri dhe kanë për qëllim përmirësimin e transparencës në administrimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore, të tilla si zonat ujore dhe të mbrojtura në Shqipëri. Këto angazhime kanë të bëjnë me publikimin e informacionit për koncesionet për kompanitë private në përdorimin e burimeve natyrore krijimin e një baze të dhënash publike për zonat e ndotura. Po ashtu, angazhimet bëjnë të nevojshme edhe fushatat ndërgjegjësuese për të informuar qytetarët mbi pasojat e ndotjes në komunitetet e tyre.

STATUSI

Angazhimi 2.2

Periudha afatmesme: I kufizuar

Ligji për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore (2012) përcakton krijimin e një portali elektronik, i quajtur Regjistri kombëtar i lejeve, autorizimeve dhe koncesioneve. Në kohën e miratimit të Planit të Veprimit, u krijua dhe u botua në internet në faqen e Ministrisë së Mjedisit një bazë të dhënash për burimet ujore.¹ Baza e të dhënave tregonte autorizimet e lëshuara për përdorimin e burimeve ujore dhe disponohen në format Excel. Portali për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore paraqet një sipërmarrje shumë më të plotë. Ajo është pjesë e një projekti të asistencës të gjithanshme të zbatuar në Shqipëri nga Banka Botërore që nga maji 2013 në bashkëpunim me ministritë përkatëse dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit. Projekti i ofron asistencë qeverisë për hartimin e strategjisë kombëtare për menaxhimin të integruar të ujit, zhvillimin e kadastrës ujore si dhe për krijimin e portalit elektronik për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore.

Gjatë hartimit të raportit të ndërmjetëm, portali elektronik për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore ishte në një fazë të hershme përgatitore dhe përparimi i saj varej nga zhvillimi i kadastrës së ujit.² Vetëvlerësimi i ndërmjetëm i qeverisë e raportonte këtë angazhim si të pazbatuar.³

Afati përfundimtar: I kufizuar

Vetëvlerësimi përfundimtar i qeverisë thekson se ky angazhim u transferua nga Ministria e Mjedisit tek Ministria e Bujqësisë, por nuk janë ndërmarrë veprime të mëtjshme.

Ndërtimi i portalit nuk ka përparuar që nga shtatori 2015. Kadastra ujore është ende në një fazë të hershme zhvillimi. Në fillim të vitit 2016, Ministria e Bujqësisë hapi një tender për mbikëqyrjen teknike, verifikimin dhe vlerësimin e pavarur të një kadastrë ujore⁴ bazuar në Sistemi Informativ Gjeografik (GIS). Sipas termave të referencës, kjo kontratë shërbimi do të kryhet në 34 ditë pune gjatë një periudhe 12-mujore, duke e shtyrë afatin për në vitin 2017.

Angazhimi 3.1

Periudha afatmesme: I kufizuar

Në kohën e publikimit të Planit të Veprimit PQH (korrik 2014), baza e dhënave për zonat e mbrojtura në Shqipëri ishte online në faqen e Ministrisë së Mjedisit së bashku me një hartë të rrjetit të zonave të mbrojtura. Zhvillimi i këtij portali iu besuar Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Zhvillimi i portalit është në fazë të hershme. Portali kishte si qëllim të ofronte informacione të hollësishme për çdo zonë të mbrojtur, përfshirë këtu planet, veprimtaritë, florën, faunën, etj.

Vetëvlerësimi i Qeverisë sugjeron se ky angazhim është zbatuar pjesërisht. Megjithatë, ai nuk raporton për aktivitetet specifike të zbatuara, me përjashtim të krijimit të bazës së të dhënave të formularëve për aksesin elektronik tek të dhënat për zonat e mbrojtura. Siç sugjeron edhe përshkrimi i angazhimit, portali do të shërbejë edhe si kanal për konsultimin publik për dokumentet ligjore që lidhen me mbrojtjen e mjedisit.⁵

Afati përfundimtar: I kufizuar

Edhe pse Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ka bërë një punë të konsiderueshme për krijimin e bazës së të dhënave të zonave të mbrojtura, zbatimi i angazhimit mbetet ende i kufizuar po të kemi parasysh fokusin e tij të synuar. Agjencia ka krijuar një bazë të plotë të dhënash (format HTML) të zonave të mbrojtura si nënseksion i faqes së saj ueb, përfshirë edhe përshkrimet bazë dhe informacione për secilën nga këto zona.⁶ Megjithatë, aty nuk ka harta dixhitale dhe agjencia nuk organizoi forume interaktive konsultimi për projektligjet, rregulloret dhe strategjitë për zonat e mbrojtura.

A MUNDËSOI QEVERISJEN E HAPUR?

Të dy angazhimet kanë shumë lidhje dhe rëndësi për vlerat PQH dhe janë në përputhje me rekomandimet e shoqërisë civile për përmirësimin e transparencës dhe aksesit të lirë tek të dhënat e burimeve natyrore.

Angazhimi 2.2

Aksesi tek informacioni: Nuk ndryshoi

Angazhimi 2.2 ka pasur progres të kufizuar, gjë që ka cunuar rezultatet e kësaj nisme të rëndësishme. Aktorët e shoqërisë civile thanë se edhe pse angazhimi kishte qëllime të mira, afati kohor për zbatimin e tij ishte jorealit.

Angazhimi 3.1

Aksesi tek informacioni: I vogël

Pjesëmarrja qytetare: Nuk ndryshoi

Zbatimi i plotë i angazhimit do të kishte përmirësonte aksesin tek informacioni nëpërmjet portalit, si dhe lidhjet GIS dhe pjesëmarrjen civile nëpërmjet konsultimeve. Agjencia kombëtare ofron informacion bazë për zonat e mbrojtura, të cilat fare pak përmirësojnë aksesin tek informacioni duke qenë se këto fakte nuk ishin në

dispozicion të publikut para këtij angazhimi.⁷ Duke qenë se portali nuk ofron një mënyrë që publiku të bëjë komente për legjislacionin, ky angazhim nuk ka krijuar asnjë mundësi për pjesëmarrjen e qytetarëve.

PËRCJELLË MË TEJ?

Angazhimet nuk u mbartën për në planin e ri të veprimit.

¹ Gjendet tek bit.ly/1W7xVCN.

² Intervista me përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe me Eduart Cani, Qendra Rajonale e Mjedisit Tirana; shtator 2015.

³ Progres Raporti MRP, http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_Second%20IRM%20Report_for%20public%20comment.pdf.

⁴ Buletini Nr. 4 i APP, 1 shkurt 2016, https://www.app.gov.al/ep/DF_DocumentViewer.aspx?id=e74ba95d-41c0-43ed-9df6-fcdf288185b7.

⁵ Progres Raporti MRP, http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_Second%20IRM%20Report_for%20public%20comment.pdf.

⁶ Shih seksionin në http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=5&Itemid=289&lang=en.

⁷ http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=5&Itemid=289&lang=en.

GRUPI 4 | SHËRBIME TË THJESHTËSUARA DOGANORE

Ky grup përbëhet nga dy angazhime, si më poshtë:

Angazhimi 2.3. Sporteli Unik

Teksti i angazhimit 2.3:

Për të lehtësuar dhe përsheptuar procedurat për tregtinë në sistemin doganor, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave do të centralizojë administrimin e kërkesave dhe procedurave nëpërmjet një sporteli të vetëm (unik). Përdorimi i një sporteli unik do të zvogëlojë kohën e praktikave administrative, do të ulë koston dhe në mënyrë të pashmangshme do të rrisë nivelin e transparencës. Ndërfaqja ndërmjet sektorit privat dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave do të jetë një ndërfaqe portali ueb. Bashkëpunimi institucional dhe koordinimi i veprimeve do të bëhen në kohë reale. Sporteli unik do të rrisë nivelin e transparencës së transaksioneve ndërmjet administratës dhe sektorit privat.

Institucioni përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Institucionet mbështetëse: N/A

Data e fillimit: 2014

Data e mbarimit: 2016

Angazhimi 3.4. Dokumenti elektronik

Teksti i angazhimit 3.4:

Formularët dhe dokumentet që duhet plotësuar për procedura të ndryshme në sistemin doganor nuk janë vetëm të komplikuar, por edhe të shumta. Në synimin për të lehtësuar aksesin në sistemin doganor do të prezantohet e-dokumenti (dokumenti elektronik). Jo vetëm që do të lehtësojmë përdorimin e formularëve dhe dokumenteve të ndryshme, por do të kontribuojmë edhe në krijimin e një mjedisi pa letra. Ofrimi i shërbimeve publike në mënyrë elektronike përmes e-dokumenteve dhe e-formularëve do të lehtësojë procedurat për qytetarët dhe biznesin, duke ulur koston dhe kohën e përdorur për këtë shërbime. Kjo gjë do të përmirësojë edhe nivelin e aksesit tek informacioni për qytetarët duke i bërë procedurat më transparente. E-Dokumentet do të:

- 1. Përmirësojnë aksesin e publikut duke i bërë të disponueshme në internet dokumentet e zgjedhura, transparencën dhe informacionin e vlefshëm për qytetarët.*
- 2. Riorganizojnë shërbime të qytetarëve duke u mundësuar të licencuarve të paraqesin dokumente elektronike me aplikimet e tyre online.*
- 3. Rrisin efikasitetin duke eliminuar dorëzimin, marrjen dhe ri-dorëzimin e dokumenteve në letër, dhe duke ulur kohën e shpenzuar në kërkim për dokumentet e humbura.*
- 4. Ulin koston dhe rrëmujën e lidhur me proceset manuale me letra dhe shtypjen dhe arkivimin e të dhënave në letër.*
- 5. Mundësojnë publikut të dorëzojë dokumente elektronike me formularët online për ankesat.*

Institucioni përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Institucionet mbështetëse: N/A

PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT	DETAJIMI				LIDHJA ME VLERËN POH (siç është shkruar)				NDIKIMI I MUNDSHËM				PËRFUNDIMI		AFATMESËM		A MUNDËSOI QEVERISJE TË HAPUR?				
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Aksesi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
2.3. Sporteli unik			X		E paqartë					X				X				X			
3.4. E-dokumenti			X		E paqartë				X					X				X			

SYNIMI I ANGAZHIMEVE:

Procedurat doganore në Shqipëri kanë qenë me kosto financiare dhe kohore për operatorët private si dhe për punonjësit e doganave ku përpunohen aplikimet doganore.

Angazhimet e Sportelit Unik dhe e-Dokumentit synojnë përmirësimin e shërbimeve doganore për operatorët në sistemin e shkëmbimit tregtar të Shqipërisë. Këto arrihen duke ulur kostot dhe duke lehtësuar procedurat si për operatorët ekonomikë ashtu edhe për administratën doganore. Sporteli unik kishte si qëllim të siguronte një sistem të ndërlidhur (rrjet telematik) që i bënte të mundur institucioneve shtetërore të komunikojnë dhe shkëmbejnë dokumente elektronike (e-dokumentit).

STATUSI

Angazhimi 2.3

Periudha afatmesme: I kufizuar

Është bërë progres i kufizuar në zbatimin e Sportelit Unik. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka ngritur një grup pune për projektin, i cili ishte ende në fazat e hershme të zhvillimit në kohën e përfundimit të vitit të parë të planit të veprimit. Qeveria priste të kishte vonesa në projekt për shkak të problemeve teknike. Për funksionimin e Sportelit Unik kërkohen investime të tjera në sistemin TIK të institucioneve të tjera shtetërore.

Afati përfundimtar: I kufizuar

Nuk është bërë progres i mëtjshëm në zbatimin e Sportelit Unik në 2015-2016. Raporti i vetëvlerësimit përfundimtar të qeverisë (shtator 2016) nuk përmend asnjë zhvillim të ri përveçse një trajnimi për projektin e Sportelit Unik. Seanca e trajnimit që u organizua në qershor 2016 fokusohet në zhvillimin e njohurive dhe kaptiteteve të një ekipi bazë ekspertësh shqiptarë për planifikimin, përgatitjen dhe zbatimin e Projektit të Sportelit Unik.¹

Angazhimi 3.4

Periudha afatmesme: I kufizuar

Përfaqësuesit e intervistuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave raportonin se AKSHI-t i ishte ngarkuar detyra e hapjes së procedurës së tenderit, procedurë e cila gjatë kohës së hartimit të raportit të ndërmjetëm nuk ishte shpallur ende.

Afati përfundimtar: I kufizuar

Nuk është bërë përparim i mëtejshëm në zbatimin e angazhimit të e-dokumentit në 2015-2016. Raporti i vetëvlerësimit përfundimtar të qeverisë citon se “zhvillimi dhe zbatimi i një projekti që bazohet në procedura doganore elektronike kanë përfunduar.” Megjithatë, projekti i procedurave elektronike që i referohet raporti i vetëvlerësimit është një projekt tjetër, që ka të bëjë me operacionet e brendshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Angazhimi i Dokumentit elektronik ka të bëjë me ofrimin në formë elektronike të shërbimeve publike nëpërmjet e-dokumenteve dhe e-formularëve. Kjo gjë synonte të zëvendësonte të ashtuquajturin sistem i “postierit” për operatorët e biznesit, duke thjeshtësuar dhe grupuar procesin. Aktualisht, operatorëve të biznesit u duhet të shkojnë në shumë institucione për të marrë dokumentet zyrtare për doganat. Por shërbimi i ri nuk është ende në funksionim. Raporti i vetëvlerësimit përfundimtar të qeverisë vëren se ky angazhim do të ketë nevojë për ndryshim në legjisllacion.

A MUNDËSOI QEVERISJEN E HAPUR?

Raporti afatmesëm MRP konstatoi se këto angazhime nuk kishin lidhje me vlerat PQH të aksesit tek informacioni, pjesëmarrja qytetare dhe llogaridhënia publike. Progresi i kufizuar i zbatimit nuk ka treguar rezultate të hershme që do të mund të kontribuonin në hapjen e qeverisë.²

PËRCJELLË MË TEJ?


Angazhimet nuk u mbartën për në planin e ri të veprimit.

¹ Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara (UNECE), <http://www.unece.org/tradewelcome/trademeetings/trade-workshops/workshops/2016/workshop-on-establishing-an-albanian-single-window/doc.html#/>.

² Progres Raporti MRP, http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_Second%20IRM%20Report_for%20public%20comment.pdf.

SHËNIME PËR METODOLOGJINË

Grupimet e angazhimeve vijnë nga plani i parë i veprimit PQH. Ky raport bazohet në analizën e angazhimeve, përfshirë këtu kërkime për programet e qeverisë, projekt ligjet dhe rregulloret, aktet nënligjore dhe raportet e ndërmjetme dhe përfundimtare të vetëvlerësimit të qeverisë. Hulimtuesi MRP u mbështet edhe tek intervistat dhe të dhënat e tjera me shkrim nga zyrtarë të qeverisë dhe aktorë të tjerë jo-shtetërorë si dhe tek analiza e raportimeve të medias.



Gjergji Vurmo është hulimtues i pavarur në Shqipëri. Ai ka një përvojë 15-vjeçare pune me organizatat e sektorit të tretë në fushat e qeverisjes së mirë, integritit evropian, zhvillimit të shoqërisë civile, dhe menaxhimit të organizatave.

Open
Government
Partnership

INDEPENDENT
REPORTING MECHANISM

Partneriteti i Qeverisë së Hapur (PQH) synon të sigurojë angazhime të qeverive ndaj qytetarëve për të promovuar transparencën, fuqizimin e qytetarëve, luftën ndaj korrupsionit, dhe për të shfrytëzuar teknologjitë e reja për forcimin e qeverisjes. Shqipëria filloi të marrë pjesë në PQH në Shtator 2011. Mekanizmi i Raportimit të Pavarur (MRP) vlerëson hartimin dhe zbatimin e planeve kombëtare të veprimit për të nxitur dialogun mes aktorëve kryesorë dhe për të përmirësuar kërkesën e llogarisë.



Independent Reporting Mechanism
Open Government Partnership
c/o OpenGovHub
1110 Vermont Ave NW Suite 500
Washington, DC 20005

Open
Government
Partnership

INDEPENDENT
REPORTING MECHANISM